



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 04.03.2025

Nr: 235

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 53 ID, DATË 26.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE

Sot më datë 04.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Zj. Anuela Ristani**
Kryetar i deleguar për Bashkinë Tiranë

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga vendimi nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, konkretisht mbështetja dhe promovimi i projekteve dhe/ose i investimeve, kombëtare ose vendore në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit dhe përdorimi i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 26.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 53 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

Data: 04.03.2025

Nr: 235
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 53 ID datë 26.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

“Partia Demokratike ka marrë djepi se në lagjen “Ali Demi” në Kryeqytet ka filluar shtrimi i rrugëve gjatë natës – apo ajo që në zhargonin popullor konsiderohet tashmë “asfalti elektoral”. Kjo ngjarje është publikuar edhe në media dhe shoqërohet me foto dhe video, të cilat lehtësisht vërtetojnë shkeljen ligjor të kryer nga Bashkia Tiranë.”

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Anuela Ristani, Kryetar i deleguar për Bashkinë Tiranë
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI